



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITORI

Nr. i lloji / Br. st. 333/20

Datum / Datum 10.04.2020

VUSHTRRI - VUČITORI



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
K r y e t a r i

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Vendimin e Qeverisë së Kosovës, nr. 01/11, lidhur me situatën e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të ndërmarrjes së masave për mbrojtje nga përhapja e korona virusit COVID-19 në territorin e Komunës së Vushtrrisë, si dhe tejkalimit me sa më pak pasoja të kësaj gjendje, Kryetari i Komunës – Kryesues i Shtabit Komunal për Emergencë, me datën 10.04.2020 merr këtë:

V E N D I M

1. Të gjitha Këshillat e Fshatrave në Komunën e Vushtrrisë marrin kompetenca detyra dhe përgjegjësi të Shtabeve Lokale për Emergencë, për parandalim të përhapjes së pandemisë me COVID-19.
2. Shtabet Lokale për Emergencë do të përcjellin në vazhdimësi gjendjen në terren në vendbanimet e tyre përsa i përket të dhënave për mundësinë e infektiveve të banorëve përmes kontakteve në mes tyre dhe informojnë te shtabi komunal i emergjencës, monitoroj gjendjen sociale dhe materiale të familjeve sociale dhe të atyre që kanë punuar ndërsa tani kanë mbete pa punë për shkak të pandemisë me koronaavirus për të i ndihmuar ato familje me ndihma në pako ushqimore dhe higjienike, bashkëpunojnë me Policinë e Kosovës dhe ninstitucionet tjera relevante komunale, si dhe do të kryejnë edhe aktivitete tjera të domosdoshme në bashkërendim me Shtabin Komunal për Emergencë në Vushtrri.
3. Shtabet Lokale për Emergencë duhet të jenë në kontakt të vazhdueshëm me shtabin komunal të komunës dhe raportojnë në baza të rregullta kur një gjë e tillë do të jetë e nevojshme. Kontakti: shkelzen.xhaferi@rks-gov.net, Tel. dhe viber: 045 111 399.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe iu komunikohet menjëherë kryetarëve të këshillave të fshatrave – shtabeve lokale emergjente.

Xhafer Tahiri



Kryetar i Komunës –
Kryesues i Shtabit Komunal
Emergjent